

PASQYRAT FINANCIARE TË SHOQËRISË
R.S & M SHPK
TË MBYLLLURA MË 31.12.2020
PËR PERIUDHËN 01.01.2020-31.12.2020

Përmbajtja :

1. Informacion i përgjithshëm për shoqërinë
2. Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare
3. Përmbledhje e politikave dhe rregullave kryesore kontabël

A. Aktivi

- Aktivet Monetare
- Aktive të Tjera Afatshkurtra
- Inventari
- Parapagime dhe Shpenzime të Shtyra
- Aktivet Afatgjata Materiale
- Aktivet Afatgjata jo Materiale

P. Pasivi – Detyrimet dhe Kapitali i Vet

- Të pagueshme ndaj Furnitorëve
- Personeli
- Detyrimet Tatimore
- Dividendë për t'u paguar
- Kapitali themeltar
- Rezerva Ligjore
- Fitimi i pashpërndarë
- Fitimi i vitit financiar 2020

C . Pasqyra e Rezultatit

- Të Ardhurat – Shitjet Neto
- Të Ardhurat nga Veprimtaritë e Shfrytëzimit
- Të Ardhurat dhe Shpenzimet Financiare
- Shpenzimet – Mallrat, Lëndët e Para dhe Shërbimet e Konsumuara...
- Shpenzimet – Kostot e Punës
- Shpenzimet e Amortizimit dhe Zhvlerësimit
- Shpenzime të Tjera
- Llogaritja e Tatimi Fitimit

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria R.S & M shpk është krijuar më 22.09.2003 me Vendim të Gjykatës së rrethit të Tiranës Nr. 30265. Sot veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr. 9901 dt 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Përfaqësues Ligjor i Shoqërisë është :

➤ z. Nikolla ÇAÇI

Shoqëria më 31.12.2020 kishte 47 punonjës të regjistruar.

Selia e Shoqërisë ndodhet në Autostrada Tirane – Durrës, Km 2, Tiranë.

Ajo është e regjistruar në DRT, Tiranë me NIPT : K 32203002 I

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është ndërtim dhe montim sinjalistikë rrugore.

2. Baza e përgatitjes së Pasqyrave Financiare

a. Mënyra e përgatitjes së Pasqyrave Financiare

Pasqyrat Financiare të Shoqërisë janë përgatitur në të gjitha aspektet e tyre materiale, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) të shpallura më 15.06.2006 si dhe me Ligjin nr. 9228 datë 29 Prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. SKK u aplikuan për herë të parë nga Shoqëria më 1 Janar 2008.

Pasqyrat Financiare të shoqërisë janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

b. Ndryshime në metodat e vlerësimit kontabël

Rishikimi i vlerësimit kontabël njihet në periudhën në të cilën vlerësimi (çmuarja) është kryer dhe në çdo periudhë që preket në të ardhmen.

c. Monedha Funktionale dhe Monedha Raportuese

Pasqyrat Financiare paraqiten në monedhën vendase Lek (ALL), e cila është monedha funksionale dhe raportuese e shoqërisë. Informacioni Financiar është paraqitur në Lekë.

3. Përmbledhje e politikave dhe rregullave kryesore kontabël

Politikat kryesore kontabël të zbatuara nga shoqëria janë të përshkruara në vijim:

a. Vlerësimi i likuiditeteve


Gjendjet e likuiditeteve përfshijnë gjendjen e parave në arkë dhe në llogaritë rrjedhëse bankare në lekë dhe në monedha të huaja.

b. Vlerësimi i Kërkesave për Arkëtim

Kërkesat për arkëtim vlerësohen me vlerën nominale (të skontuara nëse është materiale) minus humbjen nga zhvlerësimi.

c. Veprimet në Monedhe të Huaj

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen në kontabilitet me kursin e datës së kryerjes së transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj janë përkthyer në pasqyrën e bilancit me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë më 31.12.2020. Diferencat nga kursi i këmbimit të lindura nga përkthimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Aktivitetet dhe detyrimet jo monetare që maten me kosto historike, dhe janë në monedhë të huaj, përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Kursi i këmbimit për dy monedhat e huaja kryesore, me monedhën vendase, sipas Bankës së Shqipërisë më 31.12.2020.



d. Vlerësimi i Gjendjeve të Inventarit

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet dhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet në inventar janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim si vlerën me të ulet midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

e. Vlerësimi i Aktiveve Afatgjate Materiale dhe Jo Materiale

Aktivët Afatgjate Materiale (AAM) dhe Aktivët Afatgjate JoMateriale (AAJM) paraqiten në bilanc me vlerën e tyre bruto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë zhvlerësim të mundshëm. Shtesat e Aktiveve Afatgjate Materiale / JoMateriale regjistrohen në kontabilitet me koston e marrjes ose të prodhimit të tyre.

Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjelle atë aktiv në vendin dhe kushtet ekzistuese. Normat e amortizimit të aplikuara janë sipas kërkesave fiskale dhe nuk marrin në konsideratë vlerësimin e amortizimit sipas jetes së dobishme të aktivit.

Llogaritja e amortizimit për Aktivët Afatgjate Materiale dhe JoMateriale të hyra gjatë vitit bëhet duke filluar nga data 1 (një) e muajit pasardhës.

f. Vlerësimi i Detyrimeve të Pagueshme ndaj Furnitorëve

Detyrimet ndaj furnitorëve janë të vlerësuara mbi bazën e vlerës së tyre nominale.

g. Të Ardhurat

Të ardhurat nga shërbimet regjistrohen sipas masës së realizimit të tyre dhe lidhjes që ato kanë me ushtrimin e mbyllur kontabël, pavarësisht nëse arkëtimi i tyre apo i një pjese prej tyre do të ndodhë në një ushtrim pasardhës. Të ardhurat nga interesat regjistrohen në momentin e maturimit të tyre.

h. Tatim fitimi

Tatimi aktual mbi fitimin është llogaritur në përputhje me dispozitat e ligjit "Për Tatimin mbi të Ardhurat në Republikën e Shqipërisë" duke përfshirë gjithë detyrimet për tatimin mbi fitimin të pagueshme për vitin ushtrimor. Tatimet aktuale janë tatime për tu paguar që rezultojnë nga të ardhurat e tatueshme, duke përdorur shkallën tatimore që është në fuqi në datën e bilancit, dhe çdo rregullim në tatimet për t'u paguar që rrjedh nga vitet e kaluara.

Shkalla tatimore për tatimin mbi fitimin për vitin ushtrimor është 15%.

i. Fondi i Pensioneve

Shoqëria paguan kontribut për pensione si dhe për sigurime shëndetësore për punonjësit e saj siç është parashikuar në legjislacionin social në Shqipëri. Kontributet, bazuar në pagat, janë paguar në llogari të organizmave kombëtare përgjegjës për pagesën e pensioneve dhe shpenzimeve shëndetësore. Nuk ka asnjë detyrim tjetër në lidhje me fondin për pensione dhe shpenzime shëndetësore.

A. AKTIVET***Aktivët Monetare***

Gjendja e likuiditeteve rakordon me shumën e ekstrakteve të bankave dhe gjendjes së arkës në 31.12.2020. Shoqëria ka llogari bankare në lekë dhe në valutë. Për gjendjet në valutë është bërë rivlerësimi me kursin fiks të Bankës së Shqipërisë në dt. 31.12.2020 dhe diferencat janë pasqyruar në rezultatin e shoqërisë.

Gjendja e likuiditeteve sipas bankave më 31.12.2020 në vlerën **2.822.259 lekë** paraqitet si më poshtë:

Vlera arke në lekë dhe valutë	304.480 lekë
Depozita bankare në lekë	1.509.178 lekë
Depozita bankare në monedhë të huaj	1.008.601 lekë



Aktive të Tjera Financiare Afatshkurtra**Të drejta të arkëtueshme**

➤ **Klientë** të palikujduar në momentin e mbylljes së bilancit (31.12.2020) janë **179.774.153 leke**. Kjo shumë përfaqëson detyrimin e të tretëve ndaj shoqërisë për fatura të palikuiduara. Të gjitha kërkesat janë të arkëtueshme. Shuma e paraqitur më lart përputhet me inventarin analitik të datës 31.12.2020. Për klientët në valutë është bërë rivlerësimi i tyre me kursin fiks të bankës së Shqipërisë dhe diferencat janë paraqitur në pasqyrën e rezultatit të ushtrimit.

➤ **Të tjera** në fund të periudhës shoqëria rezulton me **18.146.047 lekë** :

Parapagime tatim mbi fitimin	2.018.457 lekë
Shume e paguar tepër furnitorit në pritje për tu kthyer	15.174.048 lekë
Garanci në pritje	831.391 lekë
Të drejta për t'u arkëtuar nga proceset gjyqësore	122.151 lekë

Inventari

➤ **Gjendje** më 31.12.2020 janë si më poshtë:

Lëndë e parë	17.942.120 lekë
Mallra	3.149.491 lekë
Parapagime për inventar	6.464.364 lekë

Edhe gjate vitit 2020, ashtu sikundër dhe në periudhat e mëparshme levizjet e inventarit janë mbajtur përmes metodës së koston mesatare të ponderuar. Vlersimi i Inventarit per Lëndët e para dhe Mallrat e blerë është bërë me kosto blerje.

Aktivitet Afatgjata Materiale dhe Jo materiale

Gjendja e tyre në bilanc është paraqitur për vlerën neto pas zbritjes së vlerës së amortizimit.

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje	Shtesa	Pakesime	Gjendje
			2020-01-01			2020-12-31
1	Toka		0			0
2	Ndertime		64,218,206		3.210.910	61,007,296
3	Makineri,pajsje,vegla		8,343,997	252,167	1,683,802	6,912,362
4	Mjete transporti		12,655,284	266,446	2,824,427	10,097,303
5	Pajisje kompjuterike		375,076		93,669	281,407
6	Pajisje zyre		3,203,933		640,787	2,563,146
	TOTALI		88,796,496	518,613	8,453,595	80,861,514



B (I). DETYRIMET DHE KAPITALI

Detyrimet afat shkurtra

➤ *Të pagueshme ndaj Furnitorëve*

Detyrimet të pagueshme ndaj furnitorëve në vlerën **231.398.295 lekë** përbëhen nga detyrimet ndaj furnitorëve vendas dhe të huaj, përkatësisht:

Furnitorë vendas	132.770.208 lekë
Furnitorë të huaj	34.506.409 lekë

Totali **165,276,617 lekë**

Të gjitha detyrimet janë të pagueshme. Shuma e mësipërme përputhet me inventarin analitik të datës 31.12.2020. Për furnitorët në valutë është bërë rivlerësimi i tyre me kursin fiks të Bankës së Shqipërisë dhe diferencat janë paraqitur në pasqyrën e rezultatit të ushtrimit.

➤ *Të pagueshme ndaj Punonjësve*

Detyrimet ndaj punonjësve në vlerën **1.914.195 lekë** përbëhen nga detyrimi i pagave ndaj punonjësve për vitin 2020.

➤ *Detyrimet Tatimore*

Në detyrimet tatimore janë përfshirë detyrimet si më poshtë në vlerën **12.537.305 lekë** :

Detyrimi për sigurimet shoqërore të muajit Dhjetor	1.255.984 lekë
Detyrimi për tatimin mbi të ardhurat personale	275.892 lekë
Detyrimi për Tatim mbi Vlerën e Stuar	11.005.429 lekë

Detyrimet afatgjata

- **Hua bankare** përfshihen huat bankare dhe overdrafte që ka marrë shoqëria për të përballuar nevojat e saj për likuiditete. Shoqëria ka marrë hua bankare në formën e kredive dhe të Over drafteve si më poshtë në vlerën **57.515.700 lekë**:

Kredia përbëhet nga vlera prej 57.000.000 lekë që shoqëria i detyrohet Banka Kombëtare Tregtare

Qera financiare përbëhet nga vlera prej 515.700 lekë që shoqëria i detyrohet kompanisë Raiffeisen Leasing dhe Porsche Leasing për mjetet e marra me qira financiare

B (II). KAPITALI

Kapitalet e veta janë evidentuar rregullisht dhe drejt në llogaritë përkatëse të kontabilitetit duke respektuar Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Kapitali aksioner, themeltar

Kapitali themeltar, në vlerën 107.098.681 lekë pasqyron vendimin e aksionerëve të marrë në Qershor të vitit 2016. Pra kapitali i regjistruar dhe paraqitur në QKR është 107.098.681 lekë.

Rezerva Ligjore

Rezerva ligjore me vendimin e ortakut të Qershor 2021, është bërë 7.508.483 lekë.

Fitime ose humbje të ushtrimit

Pasqyrohet në bilanc me vlerën – **2,691,031 lekë** dhe përfaqëson humbjen e shoqërisë për periudhën ushtrimore 1 Janar deri në 31 Dhjetor 2020.



PASQYRA E REZULTATIT

Shoqëria këtë vit financiar ashtu si dhe vitin e kaluar ka vendosur që t'i deklarojë të ardhurat dhe shpenzimet e saj sipas Natyrës. Treguesit kryesorë të llogarisë humbje e fitime paraqiten si më poshtë:

TË ARDHURAT

Struktura e të Ardhurave të realizuara deri më 31 Dhjetor 2020 paraqitet si më poshtë:

Shitje mallra e shërbimeve	57.309.657
Shitja e makinerive (70.000-33.554)	36,446

SHPENZIMET

Konsumi i Lëndëve të Para dhe Mallrave

Lëndë e parë e konsumuar 40.119.319 lekë
Kosto e Mallrave të shitura 1.151.158 lekë

Kostot e Punës

Posti Shpenzimet e Personelit paraqitet si me poshte:

6411	Pagat ... për personelin e furnizimit, prodhimit, ...	LEK	26,491,944
6441	Sigurimet ... për personelin e furnizimit, prodhimit, ...	LEK	4,270,097

Shpenzimet e Amortizimit dhe Zhvlerësimit

Këto shpenzime paraqiten të përmbledhura si më poshtë:

AAM 8.167.603 lekë

Shpenzime të Tjera – Shërbime Furnitura

Struktura e Shpenzimeve të tjera shfaqet si vijon:

Nr	Emri i llogarise	Monedha	Debi
1	ENERGJI,AVULL	LEK	226,733
2	QIRA	LEK	490,000
3	MIREMBAJTJE DHE RIPARIME	LEK	1,463,437
4	SIGURIME	LEK	483,572
5	TË TJERA	LEK	2,933,824
6	ROJET	LEK	2,352,000
7	SIGURIA NE PUNE	LEK	360,000
8	KANCELERI	LEK	309,167
9	CERTIFIKIMI	LEK	2,170,227
10	EKSPERTI	LEK	834,766



11	LYERJE PJEKJE	LEK	269,427
12	PUBLICITET,REKLAMA	LEK	55,500
13	SHPENZIME TELEFONIKE	LEK	1,084,389
14	SHPENZIME PËR SHËRBIMET BANKARE	LEK	224,609
15	TAKSA DHE TARIFA VENDORE	LEK	538,985
16	TAKSA E RREGJISTRIMIT	LEK	307,345
17	GJOBA DHE DËMSHPËRBLIME	LEK	4,424,452
TOTALI			17,331,698

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat

Në këtë zë, përfshihen shpenzimet e interesave për kreditë dhe over draftet e shoqërisë si dhe e ardhura nga interesat për depozitat:

767	Të ardhura nga interest	31.93
		41.25
667	Shpenzime për interesa	-8,708
6671	Interesa per qera Finaciare	-82,016
6672	Interesa kredie BKT lek	-2,320,724
		- 2,411,448

Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimit

Kjo vlerë paraqet diferencat e konvertimit që vijnë si rezultat i transaksioneve në monedhë të huaj. Ashtu si parashikon standardi kontabël, të ardhurat dhe shpenzimet që vijnë nga konvertimet e monedhave paraqiten në PASH për vlerën neto, konkretisht, të ardhura në vlerën 1,680,787 lekë dhe shpenzime konvertimi në vlerën 578,248 lekë dhe diferenca negative paraqite në PASH për vlerën 1,102,539 lekë.

Hartoi

Andi Hoxha

Miratoi

Nikolla ÇAÇI

